



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

UDHËZIM

Nr. 85, datë 11.03.2021

PËR

**PROCESIN E PLOTËSIMIT TË VENDEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR NËPËRMJET PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE,
NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NËPËRMJET KONKURRIMIT TË
HAPUR**

Në mbështetje të nenit 61, 97, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020, "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

UDHËZON:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor rregullohet nga Ligji nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020, "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Ligji nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe nga ky udhëzim.
2. Procedura e rekrutimit në shërbimin civil gjyqësor fillon me Listën e nëpunësve civilë gjyqësorë, që menaxhohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Në rast se vendi i lirë nuk plotësohet, sipas nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020, KLGJ shpall fillimin e procedurës për lëvizje paralele. Nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka të emëruar në pozicionet e lira të shpallura, atëherë vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë, për kategorinë drejtuese, dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur, për kategorinë drejtuese dhe ekzekutive.
3. Për plotësimin e vendeve të lira, në kategorinë drejtuese zhvillohet procedura e lëvizjes paralele, e ngritjes në detyrë dhe e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur. Në fillim organizohet procedura e lëvizjes paralele. Nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka të emëruar në pozicionet e lira të shpallura, atëherë vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë. Nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka të emëruar në pozicionet e lira të shpallura, atëherë vijohet me procedurën e pranimit, në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur.

4. Për plotësimin e vendeve të lira, në kategorinë ekzekutive, zhvillohet procedura e lëvizjes paralele dhe e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur. Në fillim organizohet procedura e lëvizjes paralele. Nëse në përfundim të kësaj procedure nuk ka të emëruar në pozicionet e lira të shpallura, atëherë vijohet me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur.
5. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim, për procedurën e lëvizjes paralele, për nivel drejtues dhe ekzekutiv, të përcaktuar në njoftim, nuk mund të jetë më pak se 14 (katërmëdhjetë) ditë kalendarike, nga momenti i shpalljes në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe të çdo gjykate.
6. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim, për procedurën e ngritjes në detyrë, për nivel drejtues, të përcaktuar në njoftim, nuk mund të jetë më pak se 21 (njëzet e një) ditë kalendarike, nga momenti i shpalljes në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe të çdo gjykate.
7. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim, për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor, për nivelin ekzekutiv, të përcaktuar në njoftim, nuk mund të jetë më pak se 21 (njëzet e një) ditë kalendarike, nga momenti i shpalljes në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe të çdo gjykate.
8. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim, për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor, për nivelin drejtues, të përcaktuar në njoftim, nuk mund të jetë më pak se 28 (njëzet e tetë) ditë kalendarike, nga momenti i shpalljes në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe të çdo gjykate.
9. Tre procedurat, procedura e lëvizjes paralele, e ngritjes në detyrë dhe e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur, për pozicionet drejtuese, nuk mund të jenë më shumë se 55 (pesëdhjetë e pesë) ditë kalendarike. Për të tre procedurat aplikohet në të njëjtën kohë.
10. Dy procedurat, procedura e lëvizjes paralele dhe e pranimit nga jashtë shërbimit civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur, për pozicionet ekzekutive nuk mund të jenë më shumë se 50 (pesëdhjetë) ditë kalendarike. Për të dy procedurat aplikohet në të njëjtën kohë.
11. Elementët kryesorë proceduralë, për plotësimin e vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor, janë në këtë udhëzim.
12. Me qëllim zbatimin e unifikuar të procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, gjykatat në veprimtarinë e tyre duhet të respektojnë rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.
13. “Kandidat” është personi, i cili plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuara në Ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” dhe Ligjin nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.
14. “Lista e nëpunësve civilë gjyqësorë” është lista që menaxhon Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas parashikimeve të nenit 57 të Ligjit 98/2016 dhe pikës 1 të nenit 4 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020.

15. Personat e përfshirë në të gjitha nivelet e administrimit të procesit të testimit të kandidatëve për në shërbimin civil gjyqësor, deklarojnë me shkrim që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga pjesëmarrësit apo kandidatët në proces dhe që nuk kanë lidhje familjare, ose miqësie me ta.

II. LËVIZJA PARALELE NË KATEGORINË DREJTUESE DHE KATEGORINË EKZEKUTIVE

1. Në rast se vendi i lirë në shërbimin civil gjyqësor nuk plotësohet, sipas nenit 5 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020, KLGJ njofton hapjen e procedurës për lëvizje paralele, për të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, të cilët plotësojnë kriteret për vendet e lira.
2. Njoftimi për plotësimin e vendit të lirë në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele bëhet publik nga KLGJ dhe botohet të paktën 3 (tre) javë para datës së parashikuar për vlerësimin profesional nga Këshilli i Gjykatës dhe qëndron në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate, deri në përfundim të procedurës së rekrutimit.
3. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim, për procedurën e lëvizjes paralele, të përcaktuar në njoftim, nuk mund të jetë më pak se 14 (katërbëdhjetë) ditë kalendarike nga momenti i shpalljes në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe të çdo gjykate. Në rast se dita e fundit është festë zyrtare ose pushim, afati do të shtyhet në ditën pasardhëse të punës.
4. Përveç sa është parashikuar në pikën 2, të nenit 6, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020, në shpallje do të përfshihet edhe kategoria/klasa e pagës.
5. Kancelari i gjykatës, që ka vendin vakant, verifikon kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele dhe kërkesat e veçanta, të cilat përcaktohen në shpalljen e konkurrimit, dhe përgatit listën e kandidatëve të kualifikuar, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim.
6. Kandidatët që nuk kualifikohen gëzojnë të drejtën e ankimit, sipas vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ-së.
7. Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), si më poshtë:
 - a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;
 - b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
 - c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.
8. Në rast se janë më shumë se një kandidatë, të kualifikuar për një pozicion pune, atëherë Këshilli i Gjykatës, i rendit sipas radhës së kriterëve të mëposhtme:
 - a) rezultateve të vlerësimit të punës, në rast rezultatesh të njëjta, krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta;

- b) vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës;
 - c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale që lidhen me fushën e pozicionit përkatës.
9. Anëtarët e Këshillit të Gjykatës kryejnë vlerësimin profesional të kandidatit sipas modelit të vlerësimit, Aneksit 1, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.
10. Secili anëtar i Këshillit vlerëson kandidatët për çdo element (vlerësimin, përvojën dhe trajnimin). Pikët në total mbledhen dhe pjesëtohen me tre, duke i rumbullakosur deri në një presje dhjetore.
11. Kandidati që merr më pak se 70 (shtatëdhjetë) pikë nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale, për t'u emëruar në vendin e lirë.
12. Nëse nuk ka asnjë fitues, atëherë Këshilli përfundon procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe i kërkon Kancelarit të vijojë me procedurën e ngritjes në detyrë ose pranimin në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit të tij.

III. NGRITJA NË DETYRË PËR KATEGORINË DREJTUESE NË POZICIONET E SHËRBIMIT CIVIL GJYQËSOR

13. Nëse vendi vakant për kategorinë drejtuese në shërbimin civil gjyqësor nuk plotësohet sipas procedurës së lëvizjes paralele, vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë nga një kategori më e ulët në një kategori më të lartë.
14. Njoftimi për plotësimin e vendit të lirë në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë së bashku me procedurën e lëvizjes paralele botohen të paktën 4 (katër) javë para datës së parashikuar për vlerësimin profesional nga Këshilli i Gjykatës dhe qëndron në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate, deri në përfundim të procedurës së rekrutimit.
15. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, Kancelari kryen verifikimin paraprak të aplikantëve, jo më vonë se 2 (dy) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimin të tyre, me qëllim që të verifikohet nëse ata i plotësojnë ose jo kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpallje.
16. Kandidatët që nuk kualifikohen gëzojnë të drejtën e ankimit, sipas Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ.

A. PROCEDURA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

17. Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin e kandidatëve dhe zhvillon një intervistë të strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind).
18. Vlerësimi i kandidatëve përfshin
- a. 70 (shtatëdhjetë) pikë për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar, që konsiston në vlerësimin e rezultateve të punës, përvojës profesionale dhe trajnimeve të lidhura me fushën përkatëse,
 - b. 30 (tridhjetë) pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

19. Anëtarët e Këshillit të Gjykatës kryejnë vlerësimin profesional të kandidatit sipas modelit të vlerësimit, Aneksit 2, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

B. VLERËSIMI I DOKUMENTACIONIT

20. Pikët totale për vlerësimin e dokumentacionit janë 70 (shtatëdhjetë) dhe ndahen si vijon:

- a) deri në 30 (tridhjetë) pikë për rezultatet e vlerësimit të punës:
- kandidati vlerësohet 15 (pesëmbëdhjetë) pikë për vlerësimin në nivelin “mirë”;
 - kandidati vlerësohet 30 (tridhjetë) pikë për vlerësimin në nivelin “shumë mirë”.
- b) deri në 30 (tridhjetë) pikë për përvojën profesionale lidhur me pozicionin përkatës:
- kandidati vlerësohet 5 (pesë) pikë për plotësimin e kërkesave;
 - kandidati vlerësohet 10 (dhjetë) pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave - deri në 1 vit eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;
 - kandidati vlerësohet 15 (pesëmbëdhjetë) pikë për tejkallim të kërkesave - nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;
 - kandidati vlerësohet 20 (njëzet) pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 3-5 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.
 - kandidati vlerësohet 30 (tridhjetë) pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 5 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.
- c) deri në 10 (dhjetë) pikë për trajnimin e lidhur me fushën përkatëse:
- kandidati vlerësohet 5 (pesë) pikë për tejkallim të kërkesave – 1-2 trajnime shtesë, të lidhura me fushën përkatëse;
 - kandidati vlerësohet 10 (dhjetë) pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 2 trajnime shtesë, të lidhura me fushën përkatëse.

21. Pikët për çdo element (vlerësimi i punës, përvoja e trajnimin) mbliidhen. Pikët në total mbliidhen dhe pjesëtohen me tre, duke i rumbullakosur deri në një presje dhjetore.

22. Raporti i procesit të vlerësimit hartohet me shkrim sipas Modelit të raportit Aneksit nr. 4, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

C. INTERVISTA E STRUKTURUAR ME GOJË

23. Këshilli i Gjykatës për intervistën e strukturuar me gojë, harton një sërë pyetjesh, të cilat janë të njëjta për të gjithë kandidatët.

24. Përmbajtja e pyetjeve të intervistës me gojë lidhet me njohuritë, aftësitë, kompetencat që nevojiten për pozicionin e punës, eksperiencën, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e karrierës.

25. Llojet e pyetjeve për intervistën me gojë:

- Pyetje lidhur me sjelljen;
- Pyetje lidhur me situatën (hipotetike);
- Pyetje lidhur me dijet.

26. Pyetjet lidhur me sjelljen përgatiten si më poshtë:

Situata	Përshkruani situatën, jepni detaje të mjaftueshme.
Detyra	Përshkruani detyrën - punën për të cilën ju keni qenë përgjegjës
Veprimi	Përshkruani veprimet që ju ndërmoret. Flisni për atë që keni bërë.
Rezultati	Përshkruani se çfarë ka ndodhur, se si përfundoi situata, cilat ishin mësimet e nxjerra.

Pyetjet lidhur me situatën hartohen më qëllim për t'i vënë kandidatët në një situatë të lidhur me punën në mënyrë që ata të mund të përshkruajnë sjelljen e tyre të ardhshme.

Pyetjet lidhur me dijet kërkojnë që kandidatët të përshkruajnë dijet e tyre, ose kërkojnë që ata t'i tregojnë ato.

Shembuj të llojeve të pyetjeve jepen në Aneksin nr. 3, bashkëlidhur këtij Udhëzimi.

27. Gjatë intervistës me gojë nuk bëhen pyetje në lidhje me moshën, gjendjen civile, gjendjen familjare ose planet, preferencat fetare, pikëpamjet politike, etj.

28. Kandidatët njoftohen se intervista do të regjistrohet me zë. Deklarata e pranimit, ose e mospranimit për të regjistruar intervistën me gojë duhet të nënshkruhet nga kandidatët. Kjo deklaratë duhet të përfshijë detyrimin nga ana e Këshillit të Gjykatës për të ruajtur fshehtësinë e të dhënave të kandidatit. Nëse kandidati refuzon të nënshkruajë deklaratën, atëherë intervista me gojë nuk regjistrohet.

29. Anëtarët e Këshillit të Gjykatës prezantohen dhe shpjegojnë se si do të procedohet me intervistën.

30. Secili prej anëtarëve të Këshillit të Gjykatës vlerëson çdo pyetje me pikë. Vetëm vlerësimi në total i intervistës me gojë do të shpallet.

31. Pesha e secilës pyetje për intervistën me gojë përfshihet në raportin e procedurës së ngritjes në detyrë, së bashku me një përmbledhje të shkurtër të vlerësimit të secilit kandidat. Modeli i raportit është në Aneksin Nr. 4.

32. Pikët totale për vlerësimin e intervistës me gojë janë 30 (tridhjetë). Pikët në total mbledhen dhe pjesëtohen me 3, duke i rrumbullakosur deri në një presje dhjetore.

Shembull i llogaritjes së pikëve.

Sipas aktit nënligjor - numri maksimal i pikëve për intervistën me gojë është 30 (tridhjetë).

Vendoset të bëhen 8 pyetje (numri maksimal i pikëve për pesë pyetjet e para është 2, për 2 prej pyetjeve të tjera është 5, për pyetjen e fundit është 10).

Secili anëtar i Këshillit duhet të vlerësojë çdo pyetje.

P-T Totali i Vlerësimit Maksimal = 30 pikë

Për çdo pyetje duhet të llogaritet shuma e pikëve në kolonën e fundit

Për të gjitha pyetjet duhet të llogaritet shuma në total e pikëve.

P-1	Vlerësimi Maksimal 2 pikë	2	0	2	Shuma 4
P-2	Vlerësimi Maksimal 2 pikë	0	2	1	Shuma 3
P-3	Vlerësimi Maksimal 2 pikë	1	1	0	Shuma 2
P-4	Vlerësimi Maksimal 2 pikë	1	1	0	Shuma 2
P-5	Vlerësimi Maksimal 2 pikë	2	2	2	Shuma 6
P-6	Vlerësimi Maksimal 5 pikë	4	3	1	Shuma 8
P-7	Vlerësimi Maksimal 5 pikë	5	2	4	Shuma 11
P-8	Vlerësimi Maksimal 10 pikë	7	7	6	Shuma 20

Shuma në total: Totali 56

Pikët përfundimtare për kandidatin do të jenë shuma totale e pikëve e pjesëtuar me tre. Pikët përfundimtare, totali prej 56 pjesëtuar me numrin 3 të vlerësuesve.

$56 / 3 = 18.666$ (rrumbullakoset në një shifër pas presjes dhjetore) 18.7 Pikë

Pikët për dokumentet e paraqitura dhe për intervistën me gojë, mbliidhen. Kandidati që merr më pak se 70 pikë nuk konsiderohet i suksesshëm. Këshilli i Gjykatës zgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikë maksimale, për t'u emëruar në vendin e lirë.

33. Këshilli i gjykatës i propozon listën e vendeve të punës të grupit të pozicioneve për të cilin është organizuar rekrutimi, kandidatit më të mirë, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimeve. Pasi kandidati zgjedh ose refuzon të zgjedhë një pozicion, lista i propozohet kandidatit të radhës. Kjo procedurë përsëritet derisa të plotësohen të gjitha pozicionet. Këshilli i gjykatës nxjerr aktin e emërimit paraprak.
34. Lista e fituesve të renditur sipas pikëve, raporti përfundimtar për rekrutimin dhe gjithë dokumentacioni i dërgohet edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.
35. Nëse kandidati nuk merr asnjë vendim brenda 3 (tre) ditëve, atëherë quhet se ai/ajo e ka refuzuar propozimin/propozimet.
36. Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin për kandidatin me më shumë pikë, nga lista e hartuar sipas pikës 3 të nenit 19 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020.
37. Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, Këshilli përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe njofton KLGJ-në, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit.

IV. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR PËR KATEGORINË EKZEKUTIVE DHE DREJTUESE

38. Nëse vendi vakant në shërbimin civil gjyqësor nuk plotësohet sipas procedurës së lëvizjes paralele ose të ngritjes në detyrë, vijohet me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur.
39. Procedura e pranimit në shërbimin civil gjyqësor organizohet për të gjithë kategorinë e nëpunësve civil gjyqësorë, të përcaktuar në shkronjat “ç” – “e” të nenit 50 të ligjit “Për pushtetin Gjyqësor”.
40. Njoftimi për plotësimin e vendit të lirë në shërbimin civil gjyqësor, për nivel ekzekutiv, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur, së bashku me procedurën e lëvizjes paralele botohen jo më shumë se 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike para datës së parashikuar për

vlerësimin profesional nga Komisioni i Pranimit dhe qëndron në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate, deri në përfundim të procedurës së rekrutimit.

41. Njoftimi për plotësimin e vendit të lirë në shërbimin civil gjyqësor, për nivel drejtues, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor, nëpërmjet konkurrimit të hapur, së bashku me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë botohen jo më shumë se 40 (dyzet) ditë kalendarike para datës së parashikuar për vlerësimin profesional nga Komisioni i Pranimit dhe qëndron në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate, deri në përfundim të procedurës së rekrutimit.
42. Kërkesa për aplikimin, jetëshkrimi standard dhe dokumentet e tjera të parashikuara në shpalljen për grupin e pozicioneve vakante, duhet të dërgohen pranë Gjykatës që ka shpallur vendin vakant.
43. Procedura e pranimit në shërbimin civil gjyqësor zhvillohet në dy faza:
 - a) verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të publikuara në njoftim;
 - b) vlerësimi i kandidatëve.
44. Verifikimi paraprak bëhet nga Kancelari, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i Pranimit dhe Këshilli i Gjykatës. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen përkatësisht:
 - a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
 - b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.
45. Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, Kancelari kryen verifikimin paraprak të aplikantëve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga data e mbylljes së afatit të pranimit të tyre, me qëllim që të verifikohet nëse ata i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit.
46. Kandidatët që nuk kualifikohen gëzojnë të drejtën e ankimit, sipas vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ.

A. VLERËSIMI ME SHKRIM NGA KOMISIONI I PRANIMIT

47. Komisioni i Pranimit është organ kolegjal që realizon testimin me shkrim të kandidatëve, vlerësimin e tyre dhe dorëzon në Këshillin e Gjykatës listën e kandidatëve të renditur duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë. KP-ja krijohet me vendim të Këshillit të Gjykatës, menjëherë pas shpalljes së vendit të lirë. Çdo anëtar i KP bën vlerësimin e kandidatëve gjatë vlerësimit me shkrim në mënyrë individuale, duke dhënë pikët përkatëse. Rekomandohet që anëtarët e KP të diskutojnë në lidhje me pikët përpara se të japin rezultatin përfundimtar.
48. KP ushtron këto detyra:
 - a) Organizon dhe mbikëqyr procesin e përpilimit dhe të vlerësimit të testeve.
 - b) Diskuton dhe bie dakord se sa pyetje do të përgatiten nga secili anëtar dhe nëse për disa pyetje nevojitet një peshë e ndryshme.
 - c) Merr masa për hartimin e pyetjeve të vlerësimit me shkrim, të cilat duhet të përzgjidhen nga fondi i pyetjeve të administruara nga KLGJ, përpara orës së

- hapjes së testimit ose hartohen 24 (njëzet e katër) orë përpara datës së konkurrimit dhe mbahen në fshehtësi deri në orën e hapjes së testimit.
- ç) Merr të gjitha masat që konkurrimi të zhvillohet i qetë dhe në kushte maksimale, duke ofruar të gjithë infrastrukturën e nevojshme.
 - d) Merr të gjitha masat që testet me shkrim të ruhen për një periudhë kohore 12 mujore.
49. Testi për vlerësimin me shkrim mund të përfshijë lloje të ndryshme pyetjesh:
- a) Pyetje me alternativa (për vlerësimin e njohurive, të aftësive, të zotësive, të kompetencave, etj.);
 - b) Rast studimor/shembull pune;
 - c) Pyetje të hapura;
 - ç) Ese (fakultative).
50. Rregullat e pyetjeve me alternativa:
- a) Çdo pyetje ka, të paktën, 3 (tre) përgjigje;
 - b) Çdo pyetje ka vetëm një përgjigje të saktë. Përgjigjet e tjera nuk janë të sakta, por duken bindëse;
 - c) Mos krijoni pyetje që mund të përgjigjen me po ose jo;
 - ç) Duhet të jetë e qartë se cila përgjigje është e saktë. Një praktikë e mirë është që të ketë vetëm një përgjigje të saktë dhe jo shumë përgjigje që janë vetëm "pjesërisht të sakta";
 - d) Shprehje të tilla si: "Të dy opsionet janë të sakta," Asnjë nga alternativat e mësipërme" duhet të shmangen;
 - dh) Të gjitha përgjigjet duhet të jenë të krahasueshme për sa i takon gjatësisë;
 - e) Informacioni i përsëritur në të gjitha përgjigjet duhet të vendoset në pyetje;
 - ë) Informacioni i përfshirë në pyetje nuk duhet të përsëritet tek përgjigjet;
 - f) Përgjigjet duhet të lidhen direkt me pyetjet;
 - g) Testi duhet të ndjekë rregullat uniforme të drejtshkrimit dhe të pikësimit.
51. KP mblidhet 24 (njëzet e katër) orë përpara zhvillimit të fazës së vlerësimit të kandidatëve (ose online) dhe zgjedh një grup pyetjesh.
52. Pyetjet e testit të vlerësimit me shkrim hartohen në bazë të grupit të fushave të njohurive, aftësive dhe cilësive, të përfshira në shpallje.
53. Kohëzgjatja e vlerësimit me shkrim vendoset nga KP në bazë të numrit të pyetjeve të dhëna në testin me shkrim, por nuk duhet të zgjasë më shumë se 2 (dy) orë.
54. Përfaqësuesi i Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikon praninë dhe mungesat e kandidatëve të kualifikuar për fazën e vlerësimit, duke kontrolluar dokumentin e identifikimit të secilit kandidat.
55. Kandidatët do të zhvillojnë testimin me shkrim vetëm në fletët e shpërndara nga anëtarët e komisionit.
56. Kandidatët nuk duhet të shënojnë mbi fletët që zhvillojnë testimin me shkrim, emrin e tyre apo ndonjë shënim tjetër të veçantë që e bën tezën e tyre të identifikueshme.
57. Në ambientet e testimit lejohet vetëm prezenca e anëtarëve të KP dhe personave të përcaktuar prej tyre. Kur kandidatët i nënshtrohen testit të vlerësimit me shkrim duhet të jenë të pranishëm të paktën dy anëtarë të KP.

58. Nëse në të njëjtin vend/disa ambiente organizohen disa teste në të njëjtën kohë, atëherë anëtarët KP dhe personat e caktuar prej tyre ndahen në grupe për të monitoruar procesin.
59. Kandidatëve nuk u lejohet komunikimi me askënd, madje as me anëtarët e KP gjatë zhvillimit të testimit, me përjashtim të pyetjeve teknike që i bëhen anëtarëve të KP.
60. Anëtarët e KP mblidhen për të korrigjuar testet dhe në përfundim hapin zarfin me fletët identifikuese dhe renditin pikët për secilin kandidat.
61. Shuma totale e pikëve të testimit për vlerësimin me shkrim është 60 (gjashtëdhjetë) pikë.
62. KP është përgjegjëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi, për fshehtësinë dhe sigurinë e materialeve të provimeve.
63. Kandidati përjashtohet nga testimi kur:
- a) Merr, jep informacion apo kopje, ose komunikon me kandidatë të tjerë;
 - b) Mban telefon celular, radio ose çdo mjet tjetër komunikimi në mjedisin e testimit;
 - c) Nëse ka hequr, ose ka dëmtuar kodin e sekretimit të testit (barkodin).
 - ç) Nëse ka dëmtuar testin (palosur, zhubrosur, grisur, vendosur shenja të dallueshme dhe të veçanta).
64. Në intervistën e strukturuar me gojë që zhvillohet nga Këshilli i Gjykatës, kanë të drejtë të marrin pjesë kandidatët, të cilët kanë grumbulluar më shumë se 42 (dyzet e dy) pikë (mbi 70% të pikëve) në vlerësimin me shkrim.
65. KP brenda 24 (njëzet e katër) orëve, i njofton Këshillit listën e kandidatëve sipas pikëve, ose përfundimin e procedurës pa asnjë të kualifikuar.
66. Kandidatët e renditur në listën e kandidatëve, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e njoftimit.

B. VLERËSIMI NGA KËSHILLI.

67. Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh kandidatin për vendin e lirë përkatës, duke marrë parasysh kriteret sipas pikëzimit si vijon:
- a) renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim nga KP;
 - b) 25 (njëzet e pesë) pikë për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë;
 - c) 15 (pesëmbëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.
68. Intervista e strukturuar me gojë mund të organizohet në një ose disa ditë në bazë të numrit të kandidatëve.
69. Intervista e strukturuar me gojë zhvillohet pas përfundimit të korrigjimit të vlerësimit me shkrim, por jo më vonë se 3 (tre) ditë kalendarike.
70. Këshilli i gjykatës njofton datën dhe orën e intervistës së strukturuar me gojë me e-mail dhe me telefon për secilin kandidat të interesuar.
71. Përgatitja për intervistën e strukturuar me gojë është e njëjtë siç është përcaktuar për ngritjen në detyrë.

72. Pikët totale për vitet e përvojës profesionale janë 15 (pesëmbëdhjetë) dhe ndahen si vijon:

- a) deri në 5 (pesë) pikë për vlerësimin e arsimit të lidhur me pozicionin:
 - kandidati vlerësohet 1 (një) pikë për plotësimin e kërkesave;
 - kandidati vlerësohet 2 (dy) pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave - arsimim shtesë (pa mbaruar);
 - kandidati vlerësohet 3 (tre) pikë për tejkallim të kërkesave - arsimim shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë;
 - kandidati vlerësohet 5 (pesë) pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - gradë arsimore shtesë (e mbaruar) ose diplomë shtesë në fushën që është veçanërisht e rëndësishme për institucionin.

- b) deri në 5 (pesë) pikë për përvojën e lidhur me pozicionin:
 - kandidati vlerësohet 1 (një) pikë për plotësimin e kërkesave;
 - kandidati vlerësohet 2 (dy) pikë për tejkallim të lehtë të kërkesave - deri në 1 vit eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;
 - kandidati vlerësohet 3 (tre) pikë për tejkallim të kërkesave - nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;
 - kandidati vlerësohet 5 (pesë) pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 3 (tre) vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.

- c) deri në 5 (pesë) pikë për trajnimin e lidhur me fushën:
 - kandidati vlerësohet 3 (tre) pikë për tejkallim të kërkesave – 1-2 trajnime shtesë në fushën përkatëse;
 - kandidati vlerësohet 5 (pesë) pikë për tejkallim domethënës të kërkesave - më shumë se 2 (dy) trajnime shtesë në fushën përkatëse.

Formulari i vlerësimit të dokumenteve hartohet me shkrim. Modeli në Aneksin nr. 5.

- 73. Këshilli i Gjykatës i propozon listën e vendeve të punës të grupit të pozicioneve për të cilin është organizuar rekrutimi, kandidatit me pikë maksimale, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike. Pasi kandidati zgjedh ose refuzon të zgjedhë një pozicion, lista i propozohet kandidatit të radhës. Kjo procedurë përsëritet deri sa të plotësohen të gjitha pozicionet.
- 74. Nëse kandidati nuk merr asnjë vendim brenda 3 (tre) ditëve, atëherë quhet se ai/ajo e ka refuzuar propozimin/propozimet.
- 75. Këshilli arsyeton dhe publikon vendimin për rezultatet e procedurës së pranimit brenda 7 (shtatë) ditëve nga paraqitja e kërkesës së kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente.
- 76. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit paraprak të tij. Këshilli, njofton pa vonesë KLGJ-në mbi rezultatet e procesit të pranimit.
- 77. Vendimi i shkurtuar publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të gjykatave përkatëse.
- 78. Lista e fituesve të renditur sipas pikëve, raporti përfundimtar për rekrutimin dhe gjithë dokumentacioni i dorëzohen edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Raporti i procesit të vlerësimit hartohet me shkrim. Modeli i raportit jepet në Aneksin nr. 6.

79. Këshilli në procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatit për në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, krahas procedurës së parashikuar në këtë udhëzim, zbaton edhe procedurat e parashikuara në Kreun V të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, sipas rastit, për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

Aneksi 1

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatit për lëvizjen paralele

Kriteret	Anëtari i parë	Anëtari i dytë	Anëtari i tretë	Shuma e pikëve
<p>Përvoja (50 pikë)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 10 për eksperiencën e lidhur me pozicionin ▪ 20 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave; deri në 1 vit eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar; ▪ 30 pikë për tejkalim të kërkesave; nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar, ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar; ▪ 40 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave; më shumë se 3-5 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar. ▪ 50 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave; më shumë se 5 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar 				
<p>Trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 3 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave; 1 trajnim apo kualifikim shtesë, të lidhur me fushën përkatëse; ▪ 5 pikë për tejkalim të kërkesave; 2-3 trajnime apo kualifikime shtesë, të lidhura me fushën përkatëse; ▪ 10 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave; më shumë se 3 trajnime apo kualifikime shtesë, të lidhura me fushën përkatëse. 				
<p>Vlerësimet në punë (40 pikë)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 20 pikë për vlerësimin në nivelin “mirë”; ▪ 40 pikë për vlerësim në nivelin “Shumë mirë”. 				
Shuma:				
Pikët në total:	Shuma/3			

Përmbledhje e shkurtër e vlerësimit të secilit kandidat:

Anëtari	(emri,	mbiemri,	nënshkrimi)
Anëtari	(emri,	mbiemri,	nënshkrimi)
Anëtari	(emri,	mbiemri,	nënshkrimi)

Aneksi 2

Formulari i vlerësimit të dokumenteve për ngritjen në detyrë

(vlerësimi i kritereve formale)

Kriteret	Anëtari i parë	Anëtari i dytë	Anëtari i tretë	Shuma e pikëve
<p>Vlerësimi për rezultatet e punës (30 pikë)</p> <p><input type="checkbox"/> 15 pikë për vlerësimin në nivelin “mirë”;</p> <p><input type="checkbox"/> 30 pikë për vlerësimin në nivelin “shumë mirë”.</p>				
<p>Përvoja në punë (30 pikë)</p> <p>5 pikë për eksperiencën e lidhur me pozicionin.</p> <p><input type="checkbox"/> 10 pikë për tejkalim të lehtë të kërkesave - deri në 1 vit eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;</p> <p><input type="checkbox"/> 15 pikë për tejkalim të kërkesave - nga 1-3 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose për eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar;</p> <p><input type="checkbox"/> 20 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave - më shumë se 3-5 vite eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.</p> <p>30 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave, më shumë se 5 vjet eksperiencë shtesë në fushën e kërkuar ose eksperiencë shtesë në një fushë tjetër të lidhur me pozicionin, por që nuk është kërkuar.</p>				
<p>Trajnimi (10 pikë)</p> <p><input type="checkbox"/> 5 pikë për tejkalim të kërkesave 1-2 trajnime shtesë, të lidhura me fushën përkatëse;</p> <p><input type="checkbox"/> 10 pikë për tejkalim domethënës të kërkesave - më shumë se 2 trajnime, të lidhura me fushën përkatëse;</p>				
Shuma				
Piket në total				Shuma/3

Aneksi 3

Shembuj të llojeve të pyetjeve

PYETJE LIDHUR ME SJELLJEN

Pyetje lidhur me sjelljen fillojnë me:

- "Na tregoni rreth një situatë kur.."
- "Jepni një shembull të ..."
- "Mendoni për..."

Për të sqaruar situatën mund të bëhen pyetjet në vijim:

- "Ju lutem, përshkruani më hollësisht situatën ... "
- "Cilat ishin rrethanat e situatës?"
- "Kur ndodhi kjo?"
- "Kush tjetër përveç jush mori pjesë në atë situatë?"
- "Cilët janë faktorët (personat) që ishin të lidhur me situatën? "

Për të specifikuar sjelljen mund të bëhen këto pyetje:

- "Çfarë (thatë) ju vetë konkretisht?"
- "Na tregoni se si reaguat ju... "
- "Specifikoni cilat ishin veprimet tuaja në fillim, gjatë procesit, dhe më pas ..."
- "Cili qe kontributi juaj?"
- "Çfarë bënë njerëzit e tjerë në këtë situatë? "

Për të specifikuar rezultatet mund të bëhen këto pyetje si më poshtë vijon:

- "Si përfundoi situata? "
- "Cilat qenë pasojat e situatës për ju dhe pjesëmarrësit e tjerë (të organit)"
- "Cili qe ndikimi i kësaj situatë tek ju?"
- "Ju thoni që keni qenë të mirëpritur. Kush, për çfarë dhe si ju vlerësuan ju?"

Shembujt për pyetjet që lidhen me sjelljen për vlerësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore:

- Jepni një shembull specifik të asaj që keni bërë kur keni konstatuar se opinionet tuaja dhe të kolegut tuaj ishin të ndara.
- Na tregoni se çfarë bëni kur konstatooni se kolegët tuaj nuk ju kuptojnë (idetë, konceptet).
- Na tregoni rastin kur ju keni ndihmuar kolegun tuaj për të kryer një detyrë.
- Jepni shembuj të mënyrës suaj të bashkëpunimit tuaj me departamentet (personat) e tjerë.
- Na tregoni se çfarë keni bërë gjatë viteve, në mënyrë që bashkëpunimi në kuadër të departamentit (ekipit) të ishte më i lehtë.

PYETJE QË LIDHEN ME SITUATË (HIPOTETIKE)

Qëllimi i pyetjeve të lidhura me situatën (hipotetike) është:

- Së pari, të gjejë se synimet e një personi, gatishmërinë për t'u sjellë në një mënyrë të caktuar në një situatë të caktuar.
- Së dyti, të vlerësojë nëse personi ka apo jo njohuritë që janë të nevojshme për të trajtuar një situatë të veçantë, dhe (ose) njohuritë se si të silllet në një situatë të veçantë.

Shembuj të pyetjeve të lidhura me situatën (hipotetike):

- Institucioni juaj zbaton një vendim strategjik për të ofruar shërbime për qytetarët në mënyrë elektronike. Aktualisht, ju keni filluar tashmë të ofroni disa shërbime vetëm në formë elektronike. Për shkak të kësaj është parashikuar një reduktim i kostove, por sondazhi i opinionit tregon se besimi ndaj institucionit tuaj është në rënie, numri i ankesave është rritur, dhe shfaqen artikuj kritikë. Çfarë hapash do të merrni në këtë situatë? Hartoni dhe shpjegoni planin e veprimit.
- Prezantimi duhet të përgatitet brenda 5 minutave. Koha për prezantime - rreth 15 minuta.
